NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 6 nëntor 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në ushtrim të kompetencave të tij rregullatore dhe në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit energjetik, shqyrtoi një sërë çështjesh me rëndësi për tregun e energjisë elektrike dhe mori vendime që lidhen me përcaktimin e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, licencimin e kapaciteteve të reja prodhuese, regjistrimin e impianteve të depozitimit të energjisë elektrike dhe përditësimin e kuadrit rregullator në zbatim të ligjit nr. 59/2026 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Në këtë kuadër, Bordi përcaktoi në masën 26.9 lekë/kWh çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Licencimi dhe trajtimi i mosmarrëveshjeve në sektor

Në kuadër të kompetencave të saj rregullatore, Bordi vendosi:

- Miratimin e licencimit të KESH sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga TEC-et lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 MW, dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 MW, të vendosura në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës, për një afat 5-vjeçar.

- Vijimin e procedurës administrative për shqyrtimin e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërive "VOLTON" sh.p.k. dhe OSSH sh.a., lidhur me pasojat financiare të pretenduara si rezultat i konfigurimit të gabuar të parametrave të matjes së energjisë elektrike në pikën e matjes "TONA ALB/6390". OSSH sh.a. duhet të paraqesë qëndrimin e saj me shkrim dhe dokumentacionin përkatës brenda 10 ditëve pune, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga Bordi.

Regjistrohen tre impiante të reja të depozitimit të energjisë elektrike

Në vijim të zbatimit të dispozitave kalimtare të ligjit nr. 59/2026, Bordi i ERE-s miratoi regjistrimin e tre impianteve të depozitimit të energjisë elektrike, të deklaruara nga shoqëritë "EZ-5 ENERGY" sh.p.k. dhe "KRONOS KONSTRUKSION" sh.p.k.

Impiantet e regjistruara kanë këto karakteristika:

- "EZ-5 ENERGY" sh.p.k. – fuqi ngarkimi 25 MW, fuqi shkarkimi 10 MW dhe kapacitet depozitimi 200 MWh. Fuqia e injektuar në rrjet nuk duhet të tejkalojë 10 MW në pikën e lidhjes.

- “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. – fuqi ngarkimi dhe shkarkimi 30 MW dhe kapacitet depozitimi 800 MWh. Fuqia e injektuar në rrjet nuk duhet të tejkalojë 30 MW nga centrali fotovoltaik i shoqërisë.

- “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k. – fuqi ngarkimi dhe shkarkimi 30 MW dhe kapacitet depozitimi 100 MWh. Fuqia e injektuar në rrjet nuk duhet të tejkalojë 50 MW nga centrali fotovoltaik i shoqërisë.

Regjistrimi është kryer në kuadër të licencave ekzistuese të prodhimit ose tregtimit të energjisë elektrike, sipas regjimit kalimtar të parashikuar në ligjin nr. 59/2026.

Për këto impiante lejohet operimi gjatë periudhës kalimtare, deri në 12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, me detyrimin për aplikimin për licencën përkatëse për vijimin e aktivitetit përtej këtij afati.

Përditësimi i kuadrit rregullator për licencimin

Bordi vendosi fillimin e procedurave për miratimin e:

- Rregullores për procedurat dhe afatet e dhënies, modifikimit, rinovimit, njohjes dhe transferimit të licencave;

- Rregullores për procedurat e thjeshtuara të licencimit;

- Modelit tip të Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike.

Këto nisma synojnë përshtatjen e kuadrit rregullator me kërkesat e ligjit nr. 59/2026, si dhe qartësimin dhe lehtësimin e procedurave e kritereve që zbatohen në procesin e licencimit.

Rregulla të reja për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 59/2026, Bordi vendosi fillimin e procedurave për miratimin e metodologjisë “Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” dhe të rregullores “Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit”.

Metodologjia do të përcaktojë parimet, kriteret dhe mënyrën e llogaritjes së çmimit, elementet përbërëse të tij dhe mënyrën e trajtimit të tyre, duke synuar transparencën dhe zbatimin e rregullave të qarta.

Ndërsa rregullorja do të përcaktojë kriteret dhe procedurat për vlerësimin dhe përzgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, kërkesat dhe dokumentacionin përkatës, si dhe mënyrën e administrimit të këtij procesi.

Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme

Një tjetër nismë rregullatore e miratuar nga Bordi lidhet me fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë teknike dhe financiare për ndarjen e energjisë elektrike dhe përfitimeve financiare brenda Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme.

Metodologjia do të përcaktojë mekanizmat e ndarjes së energjisë elektrike dhe përfitimeve financiare ndërmjet anëtarëve të komuniteteve, format dhe mënyrat e ndërveprimit me operatorët e rrjetit, tarifat e përdorimit të rrjetit dhe kufizimet përkatëse.

Vendimet e plota të Bordit të ERE-s publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe në Fletoren Zyrtare.